



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:304350

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05552891

C.nr.1198/2023

Gjykata Themelore Gjilan-Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, përmes gjyqtarit Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses H. K. nga, të cilën e përfaqëson me autorizim Shkelzen Feka, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për kompensimin e inflacionit në pagë, me vlerë të kontestit 537.13 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Hudhet poshtë padia me numër C.nr.1198/2023, e datës 22.12.2023, e paditëses H. K. nga, e paraqitur kundër të paditures Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, për shkak se çështja është gjë e gjykuar (Res Iudicata).

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 22.12.2023, në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditures Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, me vlerë të kontestit prej 537.13 euro.

Gjykata, më datën 29.02.2024, ka marrë përgjigjen në padi të palës së paditur, në të cilën është theksuar se lidhur me këtë çështje juridike kontestimore është vendosur njëherë me aktgjykimin C.nr.1022/2023, dhe ka kërkuar nga gjykata që konform nenit 391 pika d), padinë e paditëses ta hudhë poshtë për shkak se kjo çështje juridike kontestimore është çështje e gjykuar.

Pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, gjykata ka gjetur së për këtë çështje juridike kontestimore është vendosur njëherë sipas Aktgjykimit C.nr.1022/2023, të datës 14.02.20224 dhe se për gjykatën kjo çështje juridike kontestimore ndërmjet palëve të njejta me objekt kontesti të njejtë është lëndë e gjykuar (res iudicata), prandaj gjykata vendosi që ta hedhë poshtë padinë e paditësit.

Gjykata, sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta konform nenit 452 të LPK-së, ngase pala e paditur nuk i ka kërkuar.

Nga të cekurat më lartë, gjykata, duke u bazuar në nenin 391 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizion Civil
C.nr. 1198/2023, më datë 06.03.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi

UDHWZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë.